



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1128/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar ankesa e parashtruar nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, me shenjë ZL.Anr.1128/2017, të datës 18.12.2017, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1128/2017 me datën 18.12.2017, nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, në të cilën pretendon se në vendvotimin 0619c/02D, në fshatin Savadran kanë votuar me kusht persona që nuk janë në listë zgjedhore për Istog. Parashtruesi i ankesës kërkon që të hapet kjo kuti dhe të hetohet materialin sensitiv. Në mbështetje pretendimeve në ankesë ka bashkangjitur deklaratën e komisionarit Hajredin Mavrajt, i cili pohon se Rexhep Nikqi dhe Nazife Demiri kanë votuar në vendvotimin në Staradran 0619C/02D .

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me përgjigjen në ankesë të datës 19.12.2017, ka theksuar se personat e përmendur në ankesë Rexhep Nikqi dhe Nazife Demiri, kanë qenë të regjistruar në Komuna tjera në Pejë dhe Gjilan andaj edhe votat e tyre janë refuzuar për arsye se nuk kanë qenë të regjistruar në listën përfundimtare të votueseve për Komunën e Istogut.

PZAP-i, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Prandaj, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në deklaratën e bashkangjitur nga komisioneri Hajredin Mavraj, se kanë votuar votuesit Rexhep Nikqi dhe Nazife Demiri në vendvotimin 0619C/02D në Staradran të Komunës së Istogut nga përgjigja e KQZ-së vërtetohet fakti se të njëjtat vota janë refuzuar pasi të dy votuesit nuk janë në listën përfundimtare të votueseve të Komunës së Istogut.

Në ankesën e parashtruar ndonëse është kërkuar nga PZAP që të hapet kutia e votave me kusht në vendvotimin 0619C/02D, dhe të hetohet materiali senzitiv, në ankesë nuk janë bashkangjitur prova me të cilat do të rezultonte se kemi të bëjmë me parregullsi zgjedhore, përveç deklaratës të komisionerit Hajredin Mavraj, për dy votues për të cilët u dha sqarimi si më lart.

PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse ankesën e ankuesit e refuzoj si të pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.1128/2017 më datë 19.12.2017



Kryesuese e Panelit
Fejzullah Rexhepi



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*